


AKT THEMELIMI

I

Shoqerise Tregtare "ADIs" sh.p.k



Ne Durres, sot me Date 1, 11, 2000, ne ortaket:

1. Silvana BINJAKU me adrese Lagja 6, Rr "A Goga." Pall: 1026 Durres dhe Nr pashaporte 1309289.
2. Nikolla DAFA me adrese Lagja 12, Rr "9 Maj" Pall: 370, Durres dhe Nr pashaporte **1039098**

perpilojme kete Akt Themelimi me anen e se ciles krijojme nje Shoqeri Tregtare private.

NENI 1

Emertimi

Shoqeria Tregtare e krijuar me kapitalin themelor te Ortakeve Silvana BINJAKU dhe Nikolla DAFA emerohet "ADIs" sh.p.k. Ky emerim do te jete ne emblemen dhe vulen e Shoqerise si dhe ne te gjitha dokumentat perkatese te saj.

Shoqeria eshte private dhe me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 2

Qendra e Shoqerise

Shoqeria do te kete qendren e saj ne qytetin e Durresit ne Lagjen 12, Rr "Deshmoreve." Pall: 370, Durres

NENI 3

Shoqeria ka Statusin e Personit Juridik. Aktiviteti i saj do te zhvillohet ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar, me Aktin e Themelimit dhe Statusin e Shoqerise i cili i bashkengjitet.



NENI 4
Kohezgjatja

Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te zgjase per nje periudhe kohe 5 (pese) vjecare. Me vendim te Ortakeve themelues, ky Akt mund te zgjatet edhe per nje periudhe te pacaktuar, por Shoqeria mund te pushoje aktivitetin e saj edhe para ketij afati, ne rastet e parashikuara ne Statutin e saj.

NENI 5
Kapitali Themeltar


Kapitali Themeltar i Shoqerise perbehet nga nje shume perj 100 000 lekesh, depozituar ne nje nga Bankat Shqiptare, e cila eshte zgjedhur vete nga Ortaket themelues para krijimit te Shoqerise.

Kapitali Themeltar i Shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit qe marrin Ortaket themelues ne perputhje me ligjet ne fuqi.

NENI 6
Objekti

Objekti i kesaj Shoqerie do te jete ai i Agjensise Detare dhe Spedicionere, Agjensise Detare dhe, tregtim biletash udhetimi per pasagjere dhe automjete.

NENI 7
Administratoret



Administratoret e Shoqerise - AD Sh.p.k do te jete Silvana Binjaku, e cila do te kryeje cdo veprim te nevojshem ne favor te Shoqerise. Ajo ka te drejte te caktoje perfaqesues te saj cdo person tjeter me autorizim ose prokure te posacme, ne rastet kur e cmon te arsyeshme perfaqesimin e Shoqerise.

Administratori ka te drejte ekskluzive te firmosjes se te gjitha dokumentave ne emer te Shoqerise si dhe te perfaqesimit te saj ne te gjitha instancat shtetore dhe firmat private si brenda dhe jashte vendit.





NENI 8

Fitimet e Shoqerise

Te ardhurat qe do te rezultojne nga aktiviteti i Shoqerise, pasi te zbriten shpenzimet e ndryshme, detyrimet, taksat, tatimet, pagat e anetareve te Shoqerise, perbejne pjesen e fitimit i cili ndahet ndermjet Ortakeve themelues te Shoqerise.

NENI 9

Depozitimi i te ardhurave

Te ardhurat e Shoqerise do te depozitohen ne Bankat shqiptare ose te huaja, ku Shoqeria ka llogarite e saj rrjedhese ne vleren e parase shqiptare ose ne valute te huaj.

NENI 10

Funksionimi

Shoqeria do te fitoje personalitetin e saj juridik pas regjistrimit ne Gjykatën kompetente dhe te Organit tatimor.

Veprimtaria e Shoqerise ne teresi, organizimi dhe funksionimi i saj, shndërrimi, mbarimi dhe likuidimi pasqyrohen ne Statutin e Shoqerise, i cili i bashkëngjitet ketij Akti.

NENI 11

Ky Akt Themelimi perpilohet ne 6 (gjashte) kopje, te gjitha te barazvlefshme me njera-tjetren, nga te cilat njera ruhet ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

ORTAKET

Silvana BINJAKU

Nikolla DAFA

STATUTI

I

Shoqerise Tregtare



NENI 1

Emertimi

Shoqeria Tregtare private, krijuar ne baze te Aktit te Themelimit me date 01, 11, 2000, nga Ortaket themelues Silvana BINJAKU dhe Nikolla DAFA emerohet ADI sh.p.k.

Ky emerim do te jete ne emblemen e saj, ne llogarine e saj ne Banke, ne vulen dhe ne te gjitha dokumentat e Shoqerise.

Shoqeria fillon te drejtoj e Personit Juridik nga data e regjistrimit te saj ne Gjykatën kompetente. Ajo e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me kerkesen e legjislacionit shqiptar dhe ne dispozitat e krahmit te saj, Aktit e Themelimit dhe Statutin.

NENI 2

Vendndodhja e Shoqerise

Selia e Shoqerise do te jete ne qytetin e Durresit ne Lagja 12, Rr "Deshmoreve," Pall 370.

NENI 3

Kapitali Themeltar

Kapitali Themeltar i Shoqerise perbehet nga nje shume prej 100 000 (njqind mije) leke, te depozituar ne nje nga Bankat shqiptare dhe lirisht e transferueshme. Kapitali Themeltar i Shoqerise mund te shtohet ose pakesohet ne natyre ose ne te holla, sipas vendimit qe marrin Ortaket.



NENI 4

Kohezgjatja

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe 5 (pese) vjecare. Me vendim te ortakeve themelues ky afat mund te zgjatet per nje periudhe te pacaktuar, por Shoqeria mund te shperbehet edhe para ketij afati kur jane rastet e parashikuara ne kete Statut.

NENI 5

Ortaket themelues kane te drejte te pranojne ne kete Shoqeri edhe Ortake te tjere, ne formen dhe menyren e parashikuar ne ligj.


NENI 6

Objekti

Objekti kryesor i kesaj Shoqerie do te jete ai i agjensise detare dhe spedicionere, shpallimor, ekspeditive dhe i tregimitit te biletave per pasagjere dhe automjete.

NENI 7

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta financiare per zhvillimin e saj. Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante, caktohet nga Ortaket. Detyrimet qe mund te lindin nga veprimtaria e Shoqerise mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fonde te tjera, ose nga shuma suplementare qe mund te derdhin Ortaket, kur detyrimet nuk arrijne te mbulohen apo perballohen nga fondet rezerve.



NENI 8
Drejtimi Administrativ

Administratori i Shoqerise "AHS sh.p.k" do te jete Silvana Binjaku.
Administratori organizon dhe drejton veprimtarine e perditshme te Shoqerise dhe merr masa per percaktimin e zbatimit te planeve te perspektives, perfaqesimin e Shoqerise ne maredheniet me organizmat shteterore dhe private, vendase apo te huaja, nenshkruan ne emer te Shoqerise kontrata dhe mareveshje te ndryshme si dhe merr masa per zbatimin e tyre. Ai mund te caktoj nje person tjeter me autorizim ose prokure te posacme ne rastet kur mungon vete ose e cmon te aresyeshme perfaqesimn e Shoqerise. Administratori vendos per bilancin vjetor, per ndryshimin ne Statut, per shtimin ose pakesimin e Kapitalit Themeltar, per rritjen ose zvogelimin e aktivitetit (objektit), per zgjatjen e afatit te veprimtarise ose pushimin e parakohshem te aktivitetit, dhe percakton drejtimet kryesore te aktivitetit te Shoqerise.

NENI 9
Veprimtaria Ekonomiko-Financiare

Aktiviteti financiar i Shoqerise kryhet dhe kontrollohet nga ekonomisti i finances dhe llogaritari i cili varet dhe urdherohet nga administratoret. Aktiviteti financiar i Shoqerise mbyllet ne daten 31 Dhjetor te cdo viti. Per te ndjekur gjendjen ekonomiko-financiare te Shoqerise, hartohen bilancet periodike te cilat i paraqiten me shkrim administratoreve. Brenda 3 muajve nga mbyllja e aktivitetit financiar, pergatitet bilanci vjetor i Shoqerise me dokumentacionin e nevojshem konform menyrave dhe rregullave te percaktuara ne ligj. Mbi bazen e ketij Bilanci, administratoret cakojne masat per ecurine e mevonshme te veprimtarise se Shoqerise.

NENI 10
Ndarja e Fitimit

Te ardhurat e Shoqerise qe rezultojne gjate vitit ushtrimor, te zhveshura nga shpenzimet e ndryshme si detyrime ndaj te treteve, pagat e



punonjesve, taksave, tatimeve dhe shpenzimeve te tjera, perbejne fitimin neto te Shoqerise, i cili i mbetet ne dispozicion Ortakeve. Ky fitim do te perdoret per :

- a) zgjerimin e Kapitalit Themeltar..... 40 %
- b) krijimin e Fondit Rezerve te Shoqerise 10 %
- c) ndarjen midis ortakeve ne raport te barabarte
50 % me 50 % 50 %

NENI 11

Maredheniet e Punesimit

Me qellim qe te funksionoje dhe te kryhet sa me mire aktiviteti i Shoqerise, administratoret kane te drejte te punesojne persona fizike te zgjedhur prej tyre, konform kerkeses se ligjes ne ate numer qe ata e cmojne te aresyshem.

NENI 12

Pergjegjesia e punonjesve

Cdo peson i punesuar, qofte dhe administrator, eshte i detyruar te zbatoje kushtet e kontrates se punes te lidhur me punedhenesin, te ruaje kuadrimin e plote te dokumentacionit te veprimtarive te ndryshme qe kryen Shoqeria, te eksperiences se fituar etj. Ato e kane te ndaluar t'u japin informacion personave te tjere, kushdo qofshin ato, pa dijenine dhe miratimin e administratoreve te Shoqerise.


Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, do te veprohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar te punes.

NENI 13

Cmimet dhe levizjet e Kapitalit

Cmimet qe do te perdore Shoqeria gjate ushtrimit te aktivitetit te saj, do te vendosen perkundrejt ofertes dhe kerkeses, me perjashtim te atyre rasteve kur tarifate jane te caktuara me ligj, me akte te tjera nenligjore ose mareveshje te vecanta.





Shoqeria ka te drejte te depozitoje kapitalet e saj ne leke shqiptare ose e valute te huaj, ne ate Banke qe e zgjedh vete. Ajo ka te drejte t'i transferoje kapitalet e saj ne te holla, sa here e cmon te aresyeshme, qofte edhe ne Banka te huaja.

NENI 14

Shperndarja dhe likuidimi i Shoqerise

Aktiviteti i Shoqerise merr fund me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontrate dhe ne Statutin e Shoqerise. Shoqeria shperndahet ose priset edhe kur bilancet kontabel rezultojne negativ ose kur aktiviteti i saj eshte jo rentabel. Shperndarja e Shoqerise behet gjithmone me vendim te Ortakeve themelues. Aktiviteti i Shoqerise pushon edhe per shkaqe te tjera ligjore ose per shkaqe te forces madhore. Shperndarja e Shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkakuj tjetere qe nuk eshte parashikuar ne kete Statut.

NENI 15

Kur arrihet ne konkluzionin se Shoqeria duhet te shperndahet apo te priset, Ortaket caktojne nje apo me shume likuidatore, te cileve u percaktohen kompetencat dhe masa e shperblimit te tyre.

Likuidatorret bejne kujdes qe te shlyhen ne radhe te pare detyrimet qe mund t'u kete Shoqeria personave te trete. Ne kete rast, emertimi i Shoqerise behet "Shoqeri me likuidim e siper". Ne rast se likuidatori nuk caktohet nga Ortaket, ai mund te caktohet nga Gjykata kompetente mbi bazen e kerkeses se cdo personi te interesuar.

NENI 16

Pasuria e Shoqerise si dhe te ardhurat qe nxirren nga shitja eventuale e mjeteve te saj, pasi shlyhen detyrimet e kreditoreve te saj, nese ka te tille, i mbeten Ortakeve themelues te kryejne cdo veprim te nevojshem ne interes te Shoqerise, duke patur te gjitha kompetencat qe ka Asambleja e Ortakeve ne baze te ligjit Nr 7638, Date 19.11.1992.




NENI 17
Dispozitat e fundit

Ky Statut u hartua sot me date 1, 12, 2000, ne qytetin e Durrësit, ne 6 (gjashte) kopje me nga 6 (gjashte) flete secila, te gjitha te barazvlershme me njera-tjetren dhe do te hyje ne fuqi ditën e regjistrimit te Shoqerise ne Gjykate.

Nje kopje e ketij Statuti ruhet ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

ORTAKET

Silvana BINJAKU



Nikolla DAFA

